



Npi – 01/210 datë: 29.05.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 29.05.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -V- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 29.05.2025 (e enjte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Nga OSBE-ja z.Mefail Mustafa; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni; Asistentja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi, nga Radio Zëri i Shtimes z.Muhamet Hoxha.

Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 02.05.2025, mbledhja e Jashtëzakonshme dhe e Rregullt,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Për diskutim publik)
3. Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Pas diskutimit publik)
4. Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
5. Informatë e përgjithshme nga DKRS,
6. Informatë nga DBPZHR – Sektori i bujqësisë për mbjelljet pranverore,
7. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, ju njoftoj se Drejtorja e Shërbimeve Publike na kanë bërë me dije se është kërkuar edhe nga GIZI-Gjerman por edhe nga Ministria që të anulohet “Vendimi Npi-01-70 për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan. Me arsyetimin se duhet të bëhen disa ndryshime në këto dy dokumente “Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin Gjilan-Ferizaj” si dhe “Vlerësimi Strategjik i planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave”. Këto dokumente do të anulohen jo vetëm të Komunës tonë por të gjitha

komunave rajonale. Prandaj unë si Kryesues po propozoj që ta fusim si pikë e dytë shtesë në këtë rend dite. Pastaj arsyetimin më të detajuar do të na jep Zyrtarja znj. Albulenë Emini. Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Fillimisht, në emër të PDK-së i uroj Besartës dhe Albanës lindjen e vajzave. Si grup parlamentar ne jemi për këtë rend dite, duke përfshi edhe pikën shtesë.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Edhe ne pajtohemi me pikat e rendit të ditës, me pikën shtesë. Kërkoj sçarim nga Drejtoria për pikën shtesë. Kolegeve Besartë dhe Albana ju uroj lindjen e vajzave.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Pajtoj me rendin e ditës edhe me pikën shtesë por të paktën ta kishim marrë materialin. Ne edhe mund të presim pak për materialin.

Rexhep Gashi: Përshëndetje. Në fillim më erdhi mirë që në rendin e ditës nuk pashë ndonjë pikë që e ka kthyer Ministria në rishqyrtim. Por ja që tash po na tregoni këtu në mbledhje pikërisht për një pikë të tillë që është kthyer nga Ministria. Ka qenë mirë me na e dhënë materialin për pikën shtesë. Edhe unë jamë që të aprovohen vendimet e MAPL-së.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Uroj lindjen e vajzave të dy kolegeve. Pajtohemi me rendin e ditës, edhe me pikën shtesë si pikë e dytë pas procesverbalit. Pa dyshim që vendimet e MAPL-së duhet me i respektu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Në emër të Kuvendit kolegeve Besartës dhe Albanës i urojmë lindjen e vajzave. Në vazhdim Konstatoj Kuorumin, preznet në mbledhje janë 20 anëtarë të Kuvendit.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstënim”, miratoi rendin e ditës (me pikën shtesë nën Nr.2) si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 02.05.2025, mbledhja e Jashtëzakonshme dhe e Rregullt,
2. Propozim për anulimin e vendimit Npi-01-70 për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan (Pikë Shtesë),
3. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Për diskutim publik)
4. Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Pas diskut. publik)
5. Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
6. Informatë e përgjithshme nga DKRS,
7. Informatë nga DBPZHR – Sektori i bujqësisë për mbjelljet pranverore,
8. Pyetje – Përgjigje.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 02.05.2025, mbledhja e Jashtëzakonshme dhe e Rregullt

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi: Kërkoj një përmirësim të procesverbalit të shkolla “Bajram Curri” në Petrovë, si shqetësim të nxënësve për pengesat nga operatori të kjo shkollë, si dhe të shpenzimit të karburanteve, të shpenzimit për dreka e darka zyrtare. Si dhe shqetësimi për rritjen e stafit të Kryetarit nga 11 në 18 punëtor.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstënim”, miratoi Ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit, si dhe mbledhja e rregullt të mbajtura më 02.05.2025.

Pika 2

Propozim për anulimin e vendimit Npi-01-70 për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha znj. Albulenë Emini.

znj.Albulenë Emini, zyrtare e DSHP: Përshëndetje. Ne e kemi pranuar një shkresë-Rekomandim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor e cila na ka kërkuar që ta

bëjmë anulimin e Vendimit të Kuvendit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan, sepse është një proces i ri që do të bëhet. Me këtë rekomandim janë të njoftuara të gjitha Komunat e këtijë rekhioni, e jo vetëm komuna jonë. Prandaj unë ju ftoj që ta miratoni anulimin e këtijë vendimi, ashtu siç ka kërkuar MMPH-ja. Unë për pak minuta do ua sjelli nga një kopje të këtijë dokumenti.

z.Kadri Emini: Tani e kemi para veti dokumentin e Ministrisë ku me sa po e shoh unë Ministria nuk ka kërkuar që vendimi i Kuvendit të anulohet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Sot drejtori për Shërbime Publike është në takim të përbashkët Me Ministrinë dhe me GIZ-in Gjerman pikërisht për këtë çështje, dhe ai na ka bërë me dije se duhet ta anulojmë këtë vendim me çëllim që të hapet rruga që ky proces të fillohet nga fillimi.

z.Besnik Seferi: Ne duhet me vendos që me anulë këtë vendim sipas asaj që e arsyetoi zyrtarja e Shërbimeve Publike. Kështu që unë besoj se ne si Kuvend duhet të marrim vendim për anulimin e këtijë vendimi.

z.Përparim Ramusa: E falënderoj Albulenën për sçarimin. E kuptova që ky vendim duhet të plotësohet dhe tani kërkohet që ta anulojmë për me bërë plotësimin e tijë. Ne si PDK-ë jemi “Pro”.

z.Hamëz Tërshani: Sa e kuptova këtë vendim po kërkohet që ta anulojmë, për me bërë disa plotësime te ky plan dhe kjo strategji. Dhe kjo pra me u kthy në pikën zero.

z.Reshat Mujota: E lexova këtë arsyetim dhe unë nuk jamë jurist, por kur e kthen Ministria, është vendim i kundërligjshëm. Ne po merremi me faktin që me kthy në pikën zero. Kjo nuk është mirë sepse ne po votojmë pa u konsulltu dhe pa e pas zyrtarin ligjor.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju e dini se këtë Strategji e kanë bërë GIZI bashkë me Ministrinë, prandaj nuk mund ta fajësojmë as Kuvendin e as Ekzekutivin.

znj.Albulenë Emini, zyrtare e DSHP: Sa i përket pyetjeve të Kadri Eminit dhe Reshat Mujotës, tani pra kemi një kërkesë për anulimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01-70 në të cilin përfshihen: “PLANI NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN GJILAN-FERIZAJ” si dhe “VLERËSIMI STRATEGJIK I PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN GJILAN-FERIZAJ”. Këto dy dokumente duhet të anulohen sepse nuk kemi mujt me gjetë ndonjë modalitet për të vazhduar me këto dokumente. Kërkesa për me u anulë është jo vetëm për Komunën tonë por për të gjitha Komunat e përfshira të rekhionit. Këto duhet të anulohen për me i hapë rrugë vendimit tjetër që pritet të bëhet.

z.Rrahman Jakupi: I dëgjova me vëmendje diskutimet e Hamzës dhe Reshatit. Te pasuesi i fundit të dokumentit shkruan që duhet të anulohet, e ju quane si të doni, dhe kjo i bie që Ministria i ka gjetë 11 pika që janë në kundërshtim me ligjin. Për mu është shqetësuese sepse në vazhdimi po na vinë vendime që po na kthehen nga Ministria për rishqyrtim. Keni mbi 10 zyrtar që merren me këtë punë kështu që duhet ta kontrolloni. Kjo është jo serioze dhe unë po ndihem keq.

z.Reshat Mujota: Thae që fizibilitetin e ka bërë GIZI e në dokument po thot që e ka bërë Komuna, ku e kemi edhe llogon këtu.

znj.Albulenë Emini, zyrtare e DSHP: Për këtë Strategji ne si Komunë e kemi pas të formuar nga Kryetari një Grup Punues. Ky proces ka zgjatur mbi 2 vite. Siç e dini kjo strategji ka qenë në diskutim publik me qytetarë dhe ka kaluar në Kuvend, kjo ka qenë procedura. Mirëpo tani Ministria po kërkon nga Kuvendi që ta anulojë, arsyet i përmendëm pak më parë. Unë ju ftoj që ta votoni vendimin për anulimin e këtyre dokumenteve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -V- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 29.05.2025, unanimisht miratoi Vendim për ANULIMIN si vijon:

1. PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE NË RAJONIN GJILAN-FERIZAJ, Npi-01/71 dt. 24.02.2025.
2. VLERËSIMI STRATEGJIK I PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE, Npi-01/72 dt. 24.02.2025.

Pika 3

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028. (Për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. KAB-in e kemi pranuar tash së fundi me vonesë dhe ne si staf kemi punuar maksimalisht që ta përgatisim materialin për këtë mbledhje të Kuvendit, prandaj edhe ka ardhur edhe te ju pak me vonesë. Meqenëse materialin e kemi pranuar unë do të përpiqem që ta prezantoj në pikat Kryesore. Komuna e Shtimes për vitin 2026 planifikon të ketë një Buxhet prej 11,443,986.00 euro nga të gjitha grantet të shpërndarë nëpër kategori ekonomike, të cilat në vazhdim i lexoi. (Shih dokumentin). Ky pra është një Draft i cili duhet të shkojë në diskutim publik dhe mund të ndryshohet varësisht nga prioritetet dhe kërkesat që vijnë e që janë të arsyeshme. Kemi një kërkesë nga Ministria që të planifikojmë një rritje të pagave të DKA-ja. Në vazhdim ju ftoj që ta miratoni vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik KAB-in 2026-28. Nëse ka ndonjë pyetje jamë i gatshëm të përgjigjem.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit drejtor për prezantimin e KAB-it. Ne jemi për miratimin e vendimit që KABI- 2026-2028 të shkojë në diskutim publik. Kolegeve, Besartës dhe Albanës i urojmë lindjen e vajzave.

z.Reshat Mujota: E kemi para veti një dokument të rëndësishëm. E përkrahu vendimin që të dalë në diskutim publik. Te ky dokument më bëri përshtypje te pjesa e përkrahjes së bizneseve, si dhe te pjesa e dytë të infrastruktura, ku mund të themi se ka përparim. Por te sektorët tjerë kemi ngecje. Te bujqësia, drejtori le të bashkëpunojë dhe të jetë më konkret sepse ka nevojë shumë. Unë jamë që të dalë në diskutim publik dhe kërkoj që me bashkëpunu secili asambleist por jo me interesa personale.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Kolegeve, Besartës dhe Albanës i urojë lindjen e vajzave. Unë e kamë një kërkesë që dëgjimet publike të mbahen në të gjitha fshatrat dhe në Shtime. Ne duhet ti dëgjojmë kërkesat e qytetarëve sepse ato janë projekte për qytetarët e jo për ekzekutivin. Kërkoj që të bëhet një përmirësim të numri i banorëve e që nuk është rreth 27 mijë, por me rexhistrimin e fundit është diku rreth 24 mijë.

z.Hamëz Tërshani: Pavarësisht të gjithave unë jamë “Për” dhe i ftoj edhe kolegët me votuar “Për”, mirëpo ne kemi me e ndryshuar buxhetin sepse ne do ta marrim pushtetin.

z.Besnik Seferi: Mos me pa andërr pula që han ndonjë kokërr ajo ngordhë. E falënderoj drejtorin për prezantimin e KAB-it 2026-2028. E kam një pyetje për drejtorin se pse gjysma e buxhetit është për paga dhe mëditje? Dhe e dyta është kërkesë që te Zyra për Komunitete dhe Kthim me u rritë buxheti.

z.Rexhep Gashi: Te KAB-i 2026-2028 e kemi obligim ligjor për me qitë në diskutim publik, dhe unë pajtoj. E pashë se ishin planifiku 52 projekte, mirëpo kishte shumë projekte me nga 10 mijë euro ose me nga 5 mijë euro. Te këto projekte nuk ja vlenë që operatori veq makinerinë me qu deri aty, e leje ma me punu aty diçka. Te projektet kapitale po e kemi të njejtën gjë si përpara me segmentet e rrugëve. Unë po kërkoj që projektet e 5 mijë eurove të përmirësohen. Ky buxhet nuk është i Kryetarit por i qytetarëve. (Në vazhdim i tregoi disa fotografi)

z.Përparim Ramusa: Ashtu siç jemi dakorduar në KPF-ë KAB-i 2026-2028 do të del në diskutim publik, kështu që ne do ta përkrahim këtë vendim. Për Besnikun, por edhe kur gjelat hanë shumë misër ata ngordhin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimitisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2026-2028.**

Pika 4

Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Pas diskut. publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Albana Podvorica: Përshëndetje. Unë kamë një pyetje për Kryetarin, se a është bërë një studim i detajuar për të drejtat e fëmijëve në komunën e Shtimes? Nëse po a mundeni me na i dhënë sçarimet.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. E përshëndes punën e këtijë ekipi, për hartimin e këtijë plani të veprimit, i cili bazohet në Konventën për të drejtat e fëmijëve. Më vjen mirë që ka pas qytetarë të pranishëm në diskutim publik. Unë jam “Pro” dhe ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë këtë Plan të Punës për Ekipin për të drejtat e fëmijëve.

z.Muhamet Ademaj: Ne si grup parlamentar do ta përkrahim. Konsideroj se është bërë një punë shumë e mirë me këtë plan, uroj që të implementohet.

z.Përparim Ramusa: E falënderoj dhe e përshëndes grupin, që e ka hartuar këtë plan. Ne si PDK-ë jemi “Pro” ashtu qysh është rekomanduar nga KPF-ja.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje. Uroj asambleistëve znj. Besartë dhe znj.Albana, lindjen e vajzave. Ky është pra një Plan i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve, ku më konkretisht është marrë Nënkryetari z.Faruk Beqa, me grupin punues. Është organizuar dhe është mbajtur diskutimi publik ku ka pas qytetarë por ka marrë pjesë edhe OSBE-ja.

znj.Albana Podvorica: Na i japim rekomandimet dhe le të futen në këtë draft edhe këto.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Po mund të futen në Draft-Plan edhe ato që i tha znj.Podvorica. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi, Planin e Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve për periudhën 2025-2027.**

Pika 5

Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini: Siç e dini unë jam anëtarë i KPF-së, mirëpo kamë dhënë dorëheqje nga ky post për arsye personale të angazhimeve të shumta që i kam në aspektin e punëve private. Unë e propozoj Muhamet Ademaj që të zgjidhet në këtë post, meqenëse edhe e ka profesionin por edhe përvojën në këtë fushë.

z.Besnik Seferi: Me gjithë respektin për Kadriun si anëtarë i KPF-së, por mua nuk po më pëlqen mënyra e dorëheqjes dhe e propozimit, edhe pse unë nuk jamë kundër profesorit Muhamet Ademaj. Ne si LVV-ë jemi “Për”.

z.Kadri Emini: Pajtohem me Besnikun mirëpo emrat e anëtarëve të komitetit duhet me u nda nëpër grupe parlamentare, sepse siç e dini kemi përvojë në këtë drejtim. Unë jamë largu nga ky Komitet, kamë të drejtë që ta propozoj Muhametin meqenëse jemi në koalicion me AKR-në.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Sa i përket dorëheqjes së Kadriut unë nuk po e shoh të arsyeshme propozimin e tijë. Këtu e kemi një anëtarë të pavarur Reshat Mujota, të cilin unë e propozoj për anëtarë të KPF-së.

z.Reshat Mujota: Në disa parime me Besnikun pajtohem. Materialin e kemi marrë para 9 dite, e ky ka marrë pjesë në mbledhjen e KPF-së pardje. Unë e di që janë këto pazare, dhe për ti qitur në shesh këto pazare unë do ta pranoj kandidaturën e propozuar nga Adelina. Këtu jemi të gjithë të njëjt nuk ka grupe parlamentare, pra jemi në fund të mandatit. Unë do ta votoj vetin e jo Muhametin, dhe dua ta shoh a po ma japin votën.

z.Kadri Emini: E ka keqkuptuar Reshati se nuk ka pazare por marrëveshje. Një gjë është e vërtetë se nëse Reshati i merr votat MAPL-ja do ta kthen vendimin në rishqyrtim, sepse siç e dini kjo nuk ka të bëj vetëm me vota por edhe me përfaqësimin e subjekteve të Kuvendit në KPF-ë.

z.Reshat Mujota: Edhe U.A. e thotë që duhet me pasë përfaqësim të subjekteve politike, mirëpo në këtë rast nuk do të thot që e kthen Ministria. Drejt me thanë mua edhe po më vjen marre me thanë “Pazare”.

z.Përparim Ramusa: Kadriun e falënderoj për kontributin në KPF-ë, por i kërkoj që ta mendojë këtë vendim, për arsye se pikërisht Kadriu ka kërkuar në Ministri, pse nuk je pjesë e Komitetit, prandaj kërkoj që këtë vendim ta mendosh edhe një herë sepse ende ke kohë.

z.Rrahman Jakupi: Po flasim për KPF-në, si komiteti i përhershëm që është. Në KPF-ë ne si subjekt (PDK) nuk kemi përfaqësues, ku në fillim të mandatit nuk kemi pranuar. Më pëlqej

diskutimi yt Kadri sepse qashtu është, mirëpo duhet të vlejë për të gjithë njëjt sepse edhe KPK-ja është komiteti i përhershëm.

z.Kadri Emini: Kur i kemi themeluar Komitetet unë kamë pas thënë se PDK-së i takojnë 3 anëtarë, në KPF-ë por edhe për sa i përket kuotës gjinore. Ndërsa sa i përket KPK-së këta vullnetarisht kanë refuzuar atëherë për me qenë pjesë e këtijë komiteti.

z.Rexhep Gashi: Po diskutojmë për KPF-në, por ky komitet nuk ka pas telashe. Kemi pas komitete që MAPL-ja na i ka kthyer të paligjshme. Për këtë zavendësim na vjen materiali e që nuk ka zavendësim, por këtu në Kuvend bëhen propozimet, prandaj lirisht mund të thuhet se këto janë “Pazare”, ku Kadriu jep dorëheqje dhe bënë propozim. Megjithate po pajtoj edhe unë, sepse kanë mbetur edhe 3 muaj ditë krejt.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim”, zgjodhi z.Muhamet Ademaj – Petrovë, anëtar të ri të Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të z.Kadri Emini – Davidoc.**

Pika 6

Informatë e përgjithshme nga DKRS

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha Albana Fazliu.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS: Përshëndetje. Duke u bazuar në Planin e Punës së Kuvendit unë kamë përgatitur një informatë për punën e kësaj drejtorije. Materialin për këtë pikë e keni pranuar me kohë, dhe unë në vazhdim do ti lexoj vetëm pikat kryesore të Informatës, pastaj nëse ka pyetje unë do të përgjigjem. Në vazhdim lexoi Informatën (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj: E vlerësoj punën e drejtorisë. Duhet që të krijojmë kushte sa më të mira për rininë, mund të them se kushtet deri diku janë përmirësuar siç është Palestra Sportive, Fusha Sportive, pastaj në fushat tjera të dijës kemi Shtëpinë e Kulturës, Bibliotekën etj. Për sa i përket buxhetit sigurisht që do ta kemi parasysh edhe ne si Kuvendarë.

znj.Zejnije Veliu: E falënderojmë drejtoreshën për këtë informatë. Kemi pas çfaqje teatrale, e tash po e shohë që kemi më pak, realisht kemi kërkesa nga qytetarët që të kemi organizime më shumë të çfaqjeve teatrale.

znj.Albana Podvorica: E falënderoj drejtoreshën për informatën. Të rinjët po kanë suksese duke pas parasysh bashkëpunimin me bizneset. Te komisioni vlerësues kush janë këta dy përfaqësues të jashtëm, dhe a është respektuar rregullorja?

z.Reshat Mujota: Faleminderit për informatën. Punën e ke detyrim. Informata e mirë me fotografi, mirëpo me aktivitete je larg shumë. 15 Janari organizohet dhe është nën patronatin e Kryeministrit. (Në vazhdim lexoi fragmente nga informata dhe i komentoi). Pse në informatë nuk i keni përmendur edhe dështimet? Punën e drejtorisë unë e kamë pa në katër pika. Drejtoria duhet me pas aktivitete për Kulturën, Rininë e jo me i raportu homazhet etj. Duhet të na informoni se sa ka pas furnizim me libra, pastaj a është rritë numri i lexuesve. Far synime keni për planin e punës etj.

z.Kadri Emini: E falënderoj drejtoreshën për informatën, e cila është një informatë e detajuar. Ne sigurisht që do të dëshironim që të ketë aktivitete më shumë, por unë nuk e di se kur ka pas ndonjëher aktivitete më shumë se sa tash që ka. Drejtoria ka arritë që me krijuar kushte për me lexuar për ata që duan të lexojnë, prandaj unë vetëm e përgëzoj drejtoreshën për punën e bërë.

z.Reshat Mujota: Unë kamë shpresuar te koalicioni i juaj se keni me punuar më shumë. Por po del që ju jeni vetëm si patericë e Vetëvendosjes. Ju do të jeni prap me dy anëtarë në Kuvend. LDK-në nuk e kamë target por më sulmoi. Ta bëjmë punën me korrektësi. Puna e juaj nuk është për lavdatë por për një vetëknaqësi.

z.Kadri Emini: Pushteti nuk është marrë me Reshatin. E rëndësishme është që drejtorat po bëjnë përpjekje për me bërë punë të mira. Ne nuk po e dimë për Reshatin se kah do të vjen në Kuvend si PDK-ë, si LVV-ë, apo si i pavarur, e ky po e din për neve se do të jemi vetëm me dy anëtarë si LDK-ë.

z.Reshat Mujota: Ne kemi luftuar bollë, por nuk i kapim armët. Unë jamë i pavarur, dhe kamë mjaftueshëm nënshkrime për me hy prap në Kuvend. Garën do ta bëj të ndershme, por pak ka rëndësi se në cilin subjekt. E për Kryetarin nuk e di se për cilin do të votoj.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS: Nuk ka shkelje të ligjit të komisioni për ndarjen e subvencioneve që tri vite, dhe ka vazhduar punën tutje. Sa i përket pyetjes së Reshatit mund të them se vet ky ka kërkuar një informatë me foto e tash po ankohet për sa i përket fotografive në informatë. Sa i përket numrit të lexuesve, në informatë janë të dhënat, por po shihet që nuk e paske lexuar fare informatën. Ne si drejtori i mbështesim aktivitetet, në forma të ndryshme, mirëpo unë nuk mundem me dalë e me ecë bashkë me ta. Për herë të parë është mbajtur ora e parë e mësimi në shkolla dhe është mësuar për masakrën e Reçakut. Te çfaqjet teatrale e kemi një Memorandum Bashkëpunimi me komunën e Ferizajt, ku do të kemi të organizuar për çdo muaj nga një çfaqje teatrale.

znj.Albana Podvorica: Ne kemi të drejtë të diskutojmë prap kur drejtoresha nuk përgjigjet. Pytja është po e përsëris, te këta dy anëtarët e jashtëm të komisionit cili është ekspert e cili është nga OJQ-të?

z.Besnik Seferi: Faleminderit për informatën e kompletuar për punën e drejtorisë. Kemi pas disa dështime. Shtëpia e Kulturës është bërë vërtetë në shërbim të të interesuarve. Ka pas çfaqje dhe do të ketë prapë. Organizimi i mirë edhe mund ti stimulojë njerzit që të marrin pjesë. Kemi rritje të subvencionimit, por desha me ditë a po sjellin përfituesit e subvencioneve ndonjë raport? E përgëzoj shoqatën “Ilirida” e cila edhe do të na përfaqësojë në Turqi, jemi krenarë me te. I përkrahim dhe do ti përkrahim në vazhdimi Klubet sportive dhe Ansamblet sepse po sjellin rezultate. Shtimja tani më e ka edhe Korin edhe Ansamblin e vetë.

z.Rrahman Jakupi: I bashkëngjitem pyetjes së Albanës, për dy ekspertët. Edhe e pashë në Googel që në vitin 2019 ka filluar me orën e parë, e nuk është që ka filluar me ju për herën e parë siç e thatë. Rasti më i keq është se ai komision është themeluar në vitin 2022 ku kanë bërë ndarje në baza partiake. Kërkoj edhe një herë sçarim për anëtarët e komisionit.

z.Reshat Mujota: Nuk mu ka përgjigjë në një pyetje drejtoresha, mirëpo nëse drejtoresha rrinë te pika Pyetje-Përgjigje, unë tani do të abstenoj.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS: Sa i përket komisionit, siç e dini Kryetari e ka formuar këtë komision me vendim, dhe vendimi është publik i shpallur në Ueb-faqen e Komunës.

Pika 7

Informatë nga DBPZHR – Sektori i bujqësisë për mbjelljet pranverore

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha Gojart Bajramit.

z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR: Përshëndetje. Sot para jush në Kuvend e kamë sjellë një informatë për mbjelljet pranverore 2025 në komunën e Shtimes.

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për vitin 2025 ka planifikuar përgatitjet për mbjelljet pranverore të kulturave bujqësore dhe afati optimal për mbjelljen e shumicës së kulturave që mbillen në pranverë është 15 Prill deri me 15 Maj. Ndërsa, disa kultura perimore si: Qepa, Hudhra, Spinaqi, Sallata e gjelbërt mbillen më herët. Në Komunën tonë mbjellja e misrit dhe të lashtave tjera pranverore ka filluar brenda afatit optimal dhe këtë vit kanë zgjatur më shumë për shkak të kushtet agroklimatike, temperaturave të ulëta dhe reshjeve të shiut të shpeshta. Sipas vizitave në teren, janë vërejtur se mbirja dhe zhvillimi i bimëve është shumë i mirë. Sipërfaqet e realizuara për mbjelljet pranverore për secilën kulturë është si vijon: Misër 860 hektar; Misër me Fasule, 70 hektar; Misër i gjelbërt 170 hektar; Elb, 12.5 hektar; Tërshërë, 22 hektar; Bimë Furraxhere, 20 hektar; Perime në Serra, 37 hektar; Perime në fushë të hapur, 43 hektar; Patate, 30 hektar; Fasule monokulturë 12 hektar.

Reshati tha se informata është e varfur, por unë jamë specifikuar te kjo informatë vetëm te të mbjellurat. Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, nëse dikush ka ndonjë pyetje do të përpiqem që ti përgjigjem.

z.Reshat Mujota: Faleminderit drejtor për informatën. Pyetjen nuk e pata me tendencë. Unë edhe vetë punoj në bujqësi, prandaj edhe i përkrahu shumë ndarjen e subvencioneve në këtë sektor. Mua më shumë po më intereson përkrahja e Komunës të fermerët e mesëm dhe të vegjël. Auditori e ka gjetë një shkelje, ku i është mundësuar një fermeri me aplikuar pas afatit ligjor. Pyetja ime është pse nuk po ka subvencionim me farë? Kjo le të jetë edhe si kërkesë për ty drejtor, pastaj edhe me pleh artificial kur dihet që plehu mund të përdoret edhe të kulturat tjera si patatja etj. Pyetja e dytë është a do ti subvenciononi fermerët me teknikë bujqësore? Kërko drejtor më shumë buxhet për bujqësi, ne do të përkrahim.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit drejtor për informatën. Këto përbëjnë një fazë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të komunës së Shtimes. Është lajm i mirë për sa i përket shfrytëzimit kaq të madh të tokës bujqësore me të mbjellura pranverore. Ndërsa shqetësues është fakti që për çdo ditë toka bujqësore po mbulohet me ndërtime të ndryshme. Nuk pajtohem me ndarjen e Kultivatorëve që është bërë në komunën tonë, për arsye se nuk ka mujt me përfitu një bujk nga Davidoci që jam i bindur se e ka merituar, prandaj unë kërkoj që subvencionet të ndahen sipas meritokracisë.

z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR: Subvencionet janë bërë edhe vitin e kaluar me një thirrje, e në të cilën kanë përfutuar të gjithë fermerët të mdhej e të vegjël. Pra ka pas 280 përfitues. Edhe këtë vit po planifikojmë për subvencionim të drejtpërdrejt të bujqëve. Në muajin Qershor po planifikojmë që ta përkrahim një projekt për vaksionim, mbarësim, etj. të bagëtime pa pagesë. Ka me pas edhe një thirrje tjetër për subvencionimin e drejtpërdrejt, por për datën do të shohim gjatë rrugës. Kontrata në vitin e kaluar është lidhur me OJQ “Amaneti” të cilët kanë pasë edhe kriteret e tyre si kapacitete familjare.

Pika 8

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa: Kam pyetje për Ekzekutivin, fjala është për rrethrotullimin në rrugën “Anton Çeta” në Lagjen e Pajtimit, le ta din qytetarët keni paguar mjete për me projektu rrethrotullimin, nën dy keni pagu mjete për me rregullu rrethrotullimin, keni pagu mjete për me prish qat rrethrotullim edhe keni pagu mjete për me kthy në gjendjen e mëparshme. Dëshiroj që në përgjigje mos me u mundu me manipulu, por konkretisht me tregu pse keni abuzu me taksa të qytetarëve?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Drejtorat e dine që duhet të mbajnë shënime për pyetjet e parashtruara, pastaj kanë të drejtë me u përgjigj gojarisht në sallë por edhe me shkrim.

z.Besnik Seferi: Edhe unë pajtohem plotësisht me pyetjen që e bëri Përparimi, ekzekutivit konkretisht zotëri Emini, at projekt drejtor ne e kemi bërë bashkë për faktin që në dëgjimet publike të KAB-it nga viti i kaluar, ka qenë kërkesë e gjithë qytetarëve të Lagjes, e për të cilën keni dhënë fjalë të mdhaja që do të realizohet. Unë të pakten nuk e kam pritë nga Drejtorja e Urbanizmit që do ti ikte aj rrethrotullim të pakten pa e ditë edhe unë drejtor, te them kështu shumë sinqerisht, dhe si të tillë kur më kanë pyetur qytetarët e asj lagje qka ka ndodhë me atë rrethrotullim, unë nuk kamë ditur qka me ju thënë, dhe për këtë po dua të ma japish sqarimin e duhur çka u bë me rrethrotullimin, ku janë shku ato mjete të ndara. Unë uroj dhe shpresoj që si projekt do të jetë në realizim e sipër e nuk do të jetë në dështim? Pyetja e dytë ka të bëj me Shtabin e Pjetërshticës, aty janë disa shtylla të vendosura por nuk ka ndriçim tash e një kohë të gjatë. Marrë parasysh rendësinë e këtijë Shtabi, mendoj që Drejtorja e Shërbimeve Publike, do të duhej të marrë hapa konkret në lidhje me ndriçimin e atijë vendi. Pyetja e tretë te rruga “Ismajl Qemajli” fatmirsisht kemi shumë rrugë duke u asfaltuar, dhe asese nuk po du me kontestu pjesën e mire të punëve që po bëhen, mirëpo kjo rrugë dhe rruga “Kuvendi Arbërit” janë dy rrugë të cilat e kanë një rendësi të veçantë që duhet me u intervencione në ato rrugë sa më shpejt që është e mundur, sepse vërtet ka një frekuentim shumë të madh, dhe gjendja e tyre është duke u degraduar, shpresoj që drejtorja e ka një plan konkret për këto rrugë. Pyetja e katërt, po flasim për një projekt që drejtor e kam pa që janë filluar disa punime te rruga “Villiam

Voker” çka është tu ndodh me atë projekt, sepse e dime që jeni duke e ba ju si ekzekutiv në përgjithësi çështjen e unazës e cila do të lidhë kto mjetet apo kamionat me pesha të mëdha do të kalojnë në atë unazë, mirpo kjo rrugë po dihet që ka një rendësi të veçantë dhe është bërë njëfar kaosi kogja i madh, a planifikohet diçka a është duke u planifiku diçka lidhur me këtë rrugë pasi që kërkesat e qytetarëve jo një her por shumë here mu kanë adresuar tek unë për ti ngritur në këtë Kuvend? Pyetja e pestë, po flas për një kontratë e cila është marrë për mirëmbajtjen e varrezave, edhe këtu kamë kërkesa të veçanta se a është duke u bërë mirëmbajtja e varrezave, marrë parasysh edhe kontratën që e keni nënshkru dhe si komunë e kemi përfitu, dhe a është duke u mirëmbajtur ashtu qysh edhe janë me planifikim të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve. Pyetja e gjashtë, po ashtu po flasim edhe për mirëmbajtjen e trotuareve, më konkretisht po flas për rrugën e Lagjes së Pajtimit po edhe për disa rrugë të tjera të cilat trotuaret janë mbushur bajagi shumë me qashtjet e barit, barnishtave të ndryshme, po e vështirësojnë pak sa kalimin e aq më tepër në vendet ku ka frekuentim të fëmijëve, konkretisht duke shku në shkollë, pak po e kanë të vështirë goxha shumë, po flas sidomos për pjesën time, aty ku edhe qytetarët e Lagjes së Pajtimit kanë kërku që ta ngris si çashtje në këtë Kuvend. Pyetja e shtatë, gjithashtu e kam një pyetje për rrugën “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë, po flasim për një segment të një rruge e cila po në këtë rrugë mungon ndriçimi, kanalizimi edhe ujësjellësi, marrë parasysh që ndriçimi dhe kanalizimi është thane sipas parashtruesit të kërkesës që do të realizohet, ku jemi me hapa në lidhje me realizimin e kësaj kërkesë apo të këtij projekti që është e një rendësije të veçantë për atë lagje dhe ata banorë të asaj lagje.

z.Reshat Mujota: Pyetjet e mija janë të drejtuara për ju Kryesues. Pyetja e parë është çka është tu ndodhë me vendimin e para një viti me formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit “Sakrifica e Reçakut”? Se ky Komision u votu në Kuvend, edhe asnjëher nga Kryesuesi nuk u pru për mu formu Komisioni, me u ba i ligjshëm. Pyetja e dytë është prap për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave nëpër fshatra, në fillim të mandatit ky Komision u formu, kam bërë pyetje edhe më heret, më ke pas thanë vitin e kalua në shtator do të ja fillojmë, po vjen tu përfund mandati thuja qe katër vite po bëhen, dhe asnjë vendim dhe asnjë punë e asnjë aktivitet për formimin e Këshillave të fshatrave nuk u ba në këtë drejtim, ku unë e shoh si primare që Kshillat e fshatrave, mujnë me luajtë një rol kyq edhe te Korniza Afatmesme, edhe te kërkesat Buxhetore, që kjo kish dalë shumë ma demokratike, pse nuk formohen Kryesues, du sçarim? Pytje, në munges të drejtorit të Arsimit, në Buxhetin e kaluar u ba pak popullizëm, që kërkesa e fshatit Mollopoc për transportin e nxënësve asnjëher nuk u realizu, kurse drejtoresha e DKA ka pas thënë se këtë vit do ta bëjmë, e shkoj ky vit e nuk u realizu ajo kërkesë. Pytje për DKRS-në, drejtoresha foli për Komisionin e Këshillit Organizativ, kur na e dime që në atë Këshill Organizativ ka mospajtime, prap e keni ni Komision dhe e kena pa një reagim të Kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës që ka bë reagim që ju nuk e keni bashkpunimin institucional mes institucionit Komunes dhe Organizatave të Luftës, aj e ka ngritë këtë çështje dhe e kam pa në publikim në faqen e Organizatës edhe e kam dëgju me vëmendje kështu që kur të thirreni në Këshillet Organizative ju kisha lutë që si drejtori mos e leni barren te Këshilli por merrne përgjegjësinë e juaj. A ma jep një sqarim tash për “12 Qershorin” që pat paknaqësi a jinni dakordu me Organizatat e Luftës pas ati reagimi të Kryetarit të OVL të zotit Isak Musliu?

z.Muhamet Ademaj: Kam pyetje për drejtoreshën për Zhvillim Ekonomik, dul përjashta por me siguri dëgjon e i shënon, gjatë vitit 2020-21 ka filluar ndërtimi i një Zone Ekonomike në fshatin Gllavicë, mirëpo po e shohim se ende nuk ka përfunduar, dhe deri kurë do të jetë afati që kjo zone të funksionojë, dhe kur pritët përfundimi i punimeve në këtë Zonë Ekonomike? E kamë edhe një shqetësim që dua ta ngris në lidhje me shtyllat elektrike në lagjen “Ademaj” ku për çdo ditë po e rrezikojnë banorët e asaj lagje. Ka qe 50 vite këto shtylla nuk janë ndrruar ose zavendësu. Unë e di që Komuna nuk është kompetente, mirëpo kisha kërku nga ekzekutivi, që takimet e para që i keni me KEDS-in ta ngritini edhe këtë shqetësim, sepse aty shtylla po paraqesin rrezik për banorët e asaj lagje.

z.Rexhep Gashi: Pikërisht, unë do ta ngris një shqetësim jo pyetje, po kërkoj edhe nga ju si Kryesues i Kuvendit edhe nga Kryetari që këtë shqetësim ta marrin parasysh se është shumë me

prioritet. Shprehi shqetësimin tim dhe të qytetarëve lidhur me mbylljen e një zyre të KESKO në Komunën tonë. Kjo zyre ka luajtur një rol kyq në ofrimin e shërbimeve esenciale për qytetarët tanë duke përfshirë marrjen e informacioneve të nevojshme për llogari dhe faturime. Zgjedhjen e ankesave dhe shqetësimeve në mënyrë të drejtpërdrejt, krijimin e një ure komunikuese të drejtpërdrejt me konsumatorin. Mbyllja e kësaj zyre, jo vetëm që vështirson qasjen e qytetarëve në këto shërbime por krijon edhe një ndjenjë të neglizhencës institucionale ndaj nevojave të komunitetit tonë. Prandaj kërkoj nga Kryetari ti trajtojë këto çështje më me prioritet, të kërkoj sçarime nga zyrtarët e KESKO-s për mbylljen, arsyen e mbylljes të kësaj zyre, të inicojë bisedime me KESKO-n për rikthimin e shërbimeve ose zgjidhjen alternative, që nuk e len qytetarin pa përkrahje profesionale. Edhe pikërisht e dëgjova edhe parafolsin të cilin e ngriti një shqetësim te rasti i shtyllave elektrike, deri sa nuk kemi zyre, këto informacione qytetarët e komunës së Shtimes duhet ti marrin në Lipjan apo në Ferizaj, dhe pavarësisht si informacion si ju vështirësohet qytetarëve sepse është edhe një kosto e shërbimeve të cilët kanë me shku atje, pore dhe një humbje e një kohe të cilët kanë me shku atje, zyrja kur e ka lokacionin e vetë informacionet janë trajtu pak ma ndryshe se sa deri sa të shkojmë në Lipjan apo në Ferizaj.

znj. Albana Podvorica: Unë e kam një pyetje për DSHP-në, në rrugën “Tahir Sinani” dhe “Adem Jashari” kemi vetëm korniza, ku janë të dëmtuara dhe mungojnë shportat e mbeturinave, kamë edhe foto nëse ju intereson për me argumentu? Gjithashtu e kamë edhe një kërkesë nga mësimdhënësat e shumë shkollave ku muajt e fundit është vërë një listë e evidencave. Kërkesa e mësimdhënësve është që të largohet kjo listë, arsyeja është sepse nëpër shkolla e kemi një libër të kujdestarisë, ku nëse kemi mungesa të mësimdhënësve atëherë i kemi çdo herë mungesat e shkruara aty, dhe kërkesa e tyre është e specifikuar që të largohet një evidencë e tillë apo një listë e tillë nëpër shkolla.

z. Hamëz Tërshani: Unë e kam një pyetje në këtë rast për DSHP-në, edhe Kryetarin por asnjëri nuk janë present, megjithatë është në interes për qytetarët, po më intereson pse Kamioni, donacion që e kemi prej Gjermanisë, afërsisht një vjet ose ma shumë qëndron i parkuem dhe nuk po funksionalizohet?

z. Rrahman Jakupi: Gjatë këtijë viti ne kemi, Kuvendi i Komunës së Shtimes, gjithë anëtarët e Kuvendit kanë votuar një vendim për ngritjen e një padie ndaj avokatit të Lëvizjes Vetvendosje, Tomë Gashi për deklaratimet e tija lidhur me Reçakun. Kisha pas dëshirë me ditë çfarë ka ndodhë me këtë padi, a është ndërmarrë, a i ka kry Kryetari i Komunës detyrat siç është përcaktu me vendimin e Kuvendit të Komunës? Edhe një pyetje tjetër e kamë, a është ndryshu vendimi në fakt a është vendimi ashtu siç e kemi thanë, apo ka pas naj ndryshim në vendim, kjo është pyetja e parë meqenëse u diskutu shumë për fshatin Reçak, në fakt u ba shumë janë mbajtë aktivitetet, mirëpo ne si Kuvend ta kryejmë pjesën tone, ta dimë se çfar ka ndodhë me vendimin për ngritjen e padisë, kërkesë realisht që ka qenë kërkesë e banorëve të fshatit Reçak për me ngritë një padi ndaj Tomë Gashit për deklaratimet e tijë të pa baza dhe gënjeshtër. Pyetja e dytë është, çfarë ka ndodhë me vendimin për ndërtimin e objektit të Xhamisë, të cilin ky Kuvend e ka marrë, këtë çështje e ka ngritë në mbledhjen e kaluar edhe anëtari i Kuvendit zoti Reshat Gashi Mujota, kisha pas qef me ditë, pse aj vendim nuk është sjellë në Kuvend? Pyetja e tretë është cillat veprime janë ndërmarrë lidhur me procesin e risistemizimit të vendeve të punës me faktin që vendimi i tillë është kthi nga MAPL-ja dhe është vlerësuar si i kundërligjshëm, dhe sod e asaj dite ne ende nuk kemi asni deklaratim asnjë shfuqizim nga ana e Kryetarit, jamë duke ba pyetje lidhur me vendimin Nr.02/1172 i datës 29.12.2023 i cili është vlerësuar si akt në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të cilin e ka sjellë Ministria e Pushtetit Lokal. Pyetja tjetër është, unë e kamë bërë një kërkesë për çasje në dokumente publike lidhur me objektet pa leje, dhe në atë përgjigje nuk e kam marrë dokumentacionin e plotë. Pyetja është pse nuk më është dhanë dokumentacioni i plotë i asaj kërkesë që e kamë shtrru. Kamë edhe dy kërkesa, a është duke vazhdu marrëveshja e Organizatës Joqeveritare dhe Komunës së Shtimes, Organizata Joqeveritare Agjensia për Zhvillim Rajonal AZHR-ë, a është ajo marrveshje ende në fuqi, a është duke vazhdu dhe sa mjete financiare nga viti 2023 e këndeje janë dhënë për këtë Agjension? Në të njëjtën kohë për deri sa po i shtroj këto pyetje, nëse ka të bëjë me ndonjë

kërkesë dëshiroj që ajo kërkesë të shëndrrohet në dokument për qasje publike tash, sepse kamë të drejtë si anëtar i Kuvendit sipas Ligjit, unë për deri sa e bëj pyetjen edhe është kërkesë për çasje në dokumente publike pra gjitha marrveshjet e AZHR-së të më dërgohen në E-mail në formatin PDF pra elektronik, marrveshjet e AZHR-së nga viti 2025 që nga fillimi deri më sot që janë, nëse janë në fuqi apo Komuna i ka këto marrveshje. Çfarë ka ndodhë me kamionin e Zjarrëfikësve, ka po thuaj se një vit që aj kamion nuk është në funksion, herën e fundit ka ndodhë një aksident në fshatin Carralevë dhe në atë fshat është djegë edhe një kamion, me sa kamë informatë, ndërsa njësia e Zjarrëfikësve në Komunën e Shtimes nuk ka arritë me shku atje, është dashtë me pritë njësinë e Zjarrëfikësve nga Suhareka për me e fikë kamionin i cili ka qenë duke, në zjarrë ndërsa kamioni i cili ka qenë, donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për qytetarët e Komunës së Shtimes i mungon Bateria dmth. po thuaj se një vit. Çfarë ka ndodhë me atë kamionin e Zjarrëfikësve?

z.Rexhep Gashi: Pikërisht në këtë Kuvend është nda me kërkesën, (Urdhno)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Urdhëro te lutem veç pyetjen e parshtron.

z.Rexhep Gashi: Po de, me kërkesën e drejtorisë planifikimit urbanizmit të ndarë një parcelë për vendosjen e një trafo, çka është kah ndodhë kur e kemi nda na atë parcelë, çka është, çka ka ndodhë dhe deri ku kanë hecë proceset e procedurave për atë trafo 110 Kw e kamë fjalën, dhe një tjetër, drejtor a u ba pranimi teknik i kanalizimit 17 Shkurt në rrugën “Ibrahim Rugova” gjegjësisht Godanc – Gjyrkovc.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju kisha lutë mos i ndezni mikrofonat pa ua dhënë fjalën. Nëse nuk ka pyetje tjera atëherë drejtorët që janë prezent mund të përgjigjen gojarisht, nëse jo përgjigjen me shkrim. Ata që mungojnë natyrisht që kanë me u përgjigj me shkrim.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS: E pata një pyetje për sa i përket Shoqatave të dala nga Lufta, a jeni pajtu a keni bisedu me ata u tha nga asamblesisti Reshati, pas një fjalimi që e ka mbajtur Kryetari i OVL të UÇK-së Isak Musliu. Nejse qashtu a jeni pajtu me aktivitete. Pikërisht ai fjalim ka qenë kur e kemi mbajtur takimin e pare për “12 Qershorin” unë si drejtori ja kam propozuar një draft agjendë, i cili ka mund me u ndryshu nga secili aty që ka qenë i pranishëm, ka qenë si kërkesë e tijë që na mos me sjellë atë draft, me ardhë na bllanko dmth. pa asnjë aktivitet si drejtori, që me u propozu gjatë takimit, cilat do aktivitete që janë me u propozu aty, mirëpo na e diskutuam dhe në fund të fundit u pajtuam që aj është draft mundet me u ndryshu, edhe ato aktivitete që ken mbetën aty, kështu që takimet e radhës i vazhdojmë tutje tash edhe dmth. Agjenda finale bëhet në bashkëpunim me Këshillin Organizativ, asnjëher nuk bëhet vetëm nga ne.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Pyetje ka shumë mirëpo në pyetjet kryesore do të përgjigjem. Në këtë Kuvend as jashta këtijë Kuvendi asnjë person nuk mundet me ma determinuar se si përgjigjem, besoj se këtë e keni parasysh deri sot sa njihemi. Me u ndërlihdë te pyetjet, sa i përket rrethit në rrugën “Anton Çeta” ky do të bëhet Besnik edhe Përparim. Gjatë procesit të rrethrotullimit e kemi marrë një miratim nga Ministria e Planifikimit Hapsinor, që të asfalltohet edhe rruga “Ohri” që është përgjatë këtijë rrethrotullimi, nuk ka qenë e planifikume nga ne, është marrë së fundmi pasi ka fillu rrethrotullimi. Është edhe një shtyllë elektrike e tensionit të lartë për të cilën Komuna ka bërë kërkesë për me u disloku që rrethrotullimi të jetë funksional dhe të jetë më i madh se sa ka fillu të bëhet. Rruga “Ohri” është një kilometër nga rrethi deri në rrugën e Zborcit, që e përfshinë rrugën “Ismajl Qemajli”, edhe shpresoj që brenda këtijë viti do të bëhet me standardet e kërkuara të komunikacionit. Sa i përket rrugëve, rrugicave Komuna e Shtimes këtë vit është në proces të 40 kilometrave rrugë në të gjithë teritorin e komunës së Shtimes, ku gjithashtu kërkesa të rrugëve që besoj se secili e gjeni vetin në këto rrugë. Po e marr mundin me u përgjigj për pjesën e mirëmbajtjes së varrezave, meqenëse është pjesë e ndishme, komuna çdo vit nënshkruan kontratë për mirëmbajtje të varrezave, nuk ka qenë kontratë korrnizë ajo e vitit të kaluar, kontrata për mirëmbajtjen e varrezave veç është e nënshkruar qe dy tri ditë, çdo kush që ka pas kërkesë, le ta dinë që kontrata tjera nuk ka pas këtë vit është e nënshkrume qe tri-katër ditë besoj që është në funksion shumë shpejt. Sa i përket rrugës “Villiam Voker”, ka filluar rregullimi i kanalizimit të asaj pjese tash me një formë tjetër

për shkak ati kanalizimit të mëparshëm që ka qenë i rregullum kur dihet që aty është dikund katër metra ka qenë pjesa e kanalizimit. Sa i përket kanalizimit në rrugën “17 Shkurti” ka qenë pjesë e Ujësjetllësit Rajonal “Prishtina”, pranimin teknik as për “17 Shkurt”, sa kamë informacione as për atë pjesën prej Gjyrvkovcit deri në Muzeqinë nuk e ka ba Ujësjetllësi Rajonal për shkak të problemeve që i ka pas operatori ekonomik edhe besoj se janë në proces të përfundimit të atyre telasheve të vogla, edhe kryhet shumë shpejt. Sa i përket ndarjes së parcelës për trafo të 110 KW-së, sa unë kamë informacione, ne si komunë e kemi kry obligimin tonë ligjor për me nda parcelën, ajo është në një plan afatmesëm të KEDS-it edhe KOST-it, ndoshta me terma nuk jamë në rregull në këtë drejtim, por që nga 2026 fillon implementimi i ati trafostacioni. E di që ka qenë edhe më vonë por nga kërkesat tona është ofruar në vitin 2026-tën. Kjo i hapë shumë mundësi zhvillimore komunës Shtimes për shkak të rrjetit të energjisë elektrike. Sa i përket rrugës “Ismajl Qemajli”, e “Kuvendi Arbërit” edhe zonja asambleiste mirëpo edhe Artani në këtë rast kanë bërë kërkesa të shumta rreth qasaj rruge se janë banorë të asaj pjese, jemi tu punu që ajo rrugë të rivitalizohet komplet, që i ka dikund 800 metra nga shkolla fillore deri te rruga e Zborcit, besoj që brenda kësaj faze brenda verës përfundohet. Besoj që pjesën tjetër e kthej me shkrim nëse kam harruar ndonjë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora: 13:30h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

